

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

Drejtuar: **2A2F- L OIL**

Adresa: **Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Kulla Sky Toëer, kati 7,
ap.3, Tiranë**

Procedura e prokurimit/lotit: **"Procedurë e Hapur e Thjeshtuar"/ Marrëveshje Kuadër me
objekt: "Blerje karburanti për automjetet për nevoja të Tirana DC sha"**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Nr.Ref-30382-05-23-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Blerje karburanti për automjetet për nevoja të Tirana DC
sha"**

Fondi limit: **2.430.556 (dymilion e katërqind e tridhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë)
lekë pa tvsh.**

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.
Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër: **12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.
Lëvrimi do të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **03.06.2022**

Publikimet e mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike Nr.69, datë 30 Maj 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me
këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA "sha NUIS - K24010212N

Vlera ofertës: 2.430.556 (dymilion e katërqind e tridhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë)
lekë pa tvsh

2. Operatori Ekonomik "2A2F-L OIL" shpk"

NUIS - L41915013M

Vlera ofertës: 2.430.556 (dymilion e katërqind e tridhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA" sha NUIS - K24010212N

Për arsyt e mëposhtme:

a) Në dokumentat e tenderit, shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” Pika 2.3, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.2, përcaktohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.2 Me qëllim reduktimin e shpenzimeve dhe kursimin e kohës për Autoritetin Kontraktor, i cili kryen lëvizje të vazhdueshme brenda Tiranës, Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të kenë minimalisht 2 (dy) stacione furnizimi me karburant në territorin e Bashkisë Tiranë, brenda unazës së madhe të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit në njërën prej formave të disponimit sipas Kodit Civil **(certifikatë për vërtetim pronësie ose kontratë qiraje noteriale të vlefshme ose të jetë e pasqyruar në ekstraktin e QKB-së)** për këto stacione. Stacionet të jenë të pajisura me leje mjedisore të tipit B, Vërtetim teknik nga ISHTI, Akt teknik nga PMNZH, dhe policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Pra përcaktuar sa më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë për të vërtetuar pasjen e minimalisht 2 (dy) stacioneve të furnizimit me karburant në territorin e Bashkisë Tiranë, brenda unazës së madhe, **(certifikatë për vërtetim pronësie ose kontratë qiraje noteriale të vlefshme ose të jetë e pasqyruar në ekstraktin e QKB-së)**.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se shoqëria ofertuese “Europetrol Durres Albania” sh.a. ka paraqitur një Deklaratë Noteriale, datë 19.05.2022, ku deklarohet se “Europetrol Durres Albania” sh.a. do të marrë në përdorim nga shoqëria “Skënderi G” sh.p.k, **pa afat**, të gjitha pikat e karburanteve listuar në deklaratë, të pasqyruara e të regjistruara në QKB, në ekstraktin e regjistrit tregtar të shoqërisë “Skënderi G” sh.p.k. Gjithashtu kjo deklaratë noteriale nuk është bazuar në asnjë dispozitë të KC, në lidhje me objektin për të cilët palët kanë deklaruar dhe firmosur. Ndërkohë shoqëria “Skënderi G” sh.p.k. e cila merr përsipër në deklaratën noteriale ti ofrojë shoqërisë ofertuese “Europetrol Durres Albania” sh.a., pikat në përdorim, ka marrë me qira dy pikat e karburantit përkatësisht: një stacion furnizimi (pikë) nga qiradhënësi Frident Kuqi dhe një stacion furnizimi (pikë) nga qiradhënësi Vasil Jovani.

Nga sa më sipër parashtruar, konstatohet se shoqëria “Europetrol Durres Albania” sh.a., nuk e përmbush kriterin e dokumentacionit për stacionet e furnizimit në njërën prej **formave të disponimit sipas Kodit Civil (certifikatë për vërtetim pronësie ose kontratë qiraje noteriale) kërkuar nga AK**. Shoqëria “Europetrol Durres Albania” sh.a nuk përmbush kriterin e paraqitjes së dy stacioneve të furnizimit me kontratë qiraje, sikurse kërkohet nga AK, por në pretendim të përmbushjes së këtij kriteri ka paraqitur një deklaratë noteriale mbi marrjen **në përdorim, pa afat**, të stacioneve të furnizimit.

Kontrata e qirase dhe kontrata e huapërdorjes janë dy marrëdhënie të ndryshme mes dy palëve të cilat rregullohen me dispozita të vecanta në të drejtën civile dhe kontraktore për shkak të të drejtave dhe detyrimeve specifike që kanë duke krijuar pasoja juridike krejt të ndryshme në përmbushje të tyre.

Referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 801 “Kontrata e Qirasë” kuptohet marrëdhënia mes dy palëve, ku qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (Qiradhënësi) detyrohet ti japë palës tjetër (Qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Referuar Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 901 “Kontrata e Huapërdorjes” kuptohet marrëdhënia mes dy palëve ku njëra palë (Huadhënësi) i jep palës tjetër (Huamarrësit), pa kundërshtpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e palës që ka dhënë sendin.

Pra në Kontratën e Huapërdorjes, njëra palë (Huadhënësi) i jep palës tjetër (Huamarrësit), pa kundërshtpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send brenda një afati të caktuar ose pa afat, e të drejtë kthimmi me kërkesë të palës që ka sendin. Në rastin konkret është (stacioni i furnizimit) në afatin e caktuar në kontratë. **Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin (stacioni i furnizimit me karburant), pra në çdo moment huadhënësi “Skënderi G” mund ti kërkojë huamarrësit, shoqërisë “Europetrol Durres Albania” sh.a., mospërdorimin e stacioneve të furnizimit duke sjellë kështu pasoja në vonesë, në furnizim apo në ndërprerje të furnizimit me karburant, të cilat përkthehen në rrisht dhe akoma më tej në mosrealizimin me sukses të kontratës.**

Referuar dhe në kuptim të dispozitës të sipërcituar, operatori ekonomik nuk siguron nëpërmjet kontratës së huapërdorjes disponueshmërinë e përdorimit të stacionit të furnizimit për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës pasi në çdo moment mund të kërkohej nga huadhënësi ndërprerja e përdorimit me kërkesën e këtij të fundit (si një e drejtë legjitime të cilën e sanksionon Kodi Civil, përkatësisht në nenin 901). Sjellim në vëmendjen tuaj se Deklarata Noteriale mbi dhënien në përdorim nuk është në vetvete një kontratë në kuptim të përcaktimeve të KC.

Gjithashtu sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82, pika 1, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit, sikundër përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Sa më sipër përcaktuar, operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik mbi disponimin e stacioneve të furnizimit me pakicë në formën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

b) Në dokumentat e tenderit, shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” Pika 2.3, “Kapaciteti Teknik” pika 2.3.3, përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.3 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim, nëpërmjet të cilës të garantojnë se marrin përsipër ofrimin e furnizimit me karburant pranë stacioneve të shitjes me pakicë, me shërbim 24 orë, për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, përcaktuar sipas VKM Nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. **Gjithashtu, të garantojnë dhe deklarojnë se marrin përsipër me koston e tyre, prodhimin dhe pajisjen e Autoritetit Kontraktor me karta elektronike të personalizuar.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania” sh.a., konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar se merr përsipër **me koston e tij prodhimin dhe pajisjen me karta** të autoritetit kontraktor duke mos plotësuar pikën 2.3.3 të

kapacitetit teknik, të kriterëve të vecanta për kualifikim, përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

c) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” Pika 2.3, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.4, përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për të kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se furnizimi i mjeteve do të jetë i mundur të realizohet çdo ditë të javës brenda 24 orëve në të gjithë distributorët e furnizuesit dhe në pistoletë publike. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë të ketë të nevojshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Europetrol Durres Albania” sh.a., konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në asnjë rast se merr persiper furnizimin me pistolette publike çdo ditë të javës, 24 ore, sa herë që Autoriteti Kontraktor të kërkojë furnizim, duke mos plotësuar pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta për kualifikim përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “ 3. Autoriteti ose Enti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “2A2F- L OIL” shpk me adresë Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Kulla Sky Toëer, kati 7, ap.3, Tiranë, se oferta e paraqitur me 2.430.556 (dymilion e katërqind e tridhjetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.